



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201601990/6

Tiranë ___/___/2016

Lënda : *Rekomandojmë të merren masa ligjore për ekzekutimin e plotë të vendimit gjyqësor të formës së prerë me Nr.2918 datë 12.12.2006 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Durrës, për rikthim në punën e mëparshme të paditëses R. T.*

Drejtuar : **Z.SYRI HOXHA**
Kryetar i Zyrës Përmbarimore

DURRËS

Për dijëni : **Z.ALBERT PILO**
Drejtor i Përgjithshëm i Përmbarimit
MINISTRIA E DREJTËSISË

TIRANË

Të nderuar zotërinj,

Në ankesën e saj datë 03.10.2016, drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, shtetësja R. T. nga qyteti i Durrësit na shkruan se me vendimin gjyqësor të formës së prerë me Nr.2918 datë 12.12.2006 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Durrës, është vendosur konstatimi i pavlefshmërisë absolute të zgjidhjes së kontratës së punës midis Kapitenerisë së Portit Durrës dhe kërkueses, detyrimin e palës së paditur për rikthimin në punën e mëparshme të paditëses dhe pagimin e pagës së saj për gjithë periudhën e qëndrimit pa punë duke filluar nga data 31.05.2006 e deri në ekzekutimin e plotë të vendimit gjyqësor. Ndaj këtij vendimi është bërë ankim dhe Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin e saj me Nr.540 datë 03.12.2007 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit e shkallës së parë. Për ekzekutimin e këtyre vendimeve gjyqësore Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka lëshuar urdhërin e ekzekutimit me Nr.36 datë 21.01.2008.

Paditësja R. T. vendimet gjyqësore dhe urdhërin e ekzekutimit të lëshuar nga gjykata i ka vënë në ekzekutim në organin kompetente shtetror ***në Zyrën Përmbarimore Durrës me datë 07.04.2008***, dhe ka kërkuar prej saj marrjen e masave për ekzekutimin e tyre plotësisht. Zyra Përmbarimore Durrës ka bërë ekzekutimin e pjesës së vendimeve gjyqësore dhe nuk ka bërë ekzekutimin e plotë të tyre për rikthimin në punën e mëparshme të paditëses në bazë të parashikimeve të nenit 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet qartë dhe prerë se: "Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore".

Në nenin 606 të Kodit Procedurës Civile, thuhet se:” Ndaj debitorit që refuzon, kryen në mënyrë të paregullt, nuk respekton afatet ose kryen të kundërtën e asaj që me vendim të gjykatës është detyruar, kur nuk ka vend për përgjegjësi penale, përmbaruesi gjyqësor ka të drejtën e gjobitjes deri në 50.000 lekë në çdo rast deri në ekzekutimin e detyrimit”.

Nga studimi me kujdes i dokumentacionit të paraqitur e të administruar nga ana jonë rezulton se me dt.28.12.2012 ndaj shtetasit M. C. Përmbaruesi gjyqësor Pjetër Caka ka vendosur gjobë 50.000 lekë dhe me dt.03.11.2011 Zyra Përmbarimit Durrës ka bërë Kallëzim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 320 i Kodit Penal ndaj shtetasit G. T., të cilat nuk kanë rezultuar efektive. Me datë 16.11.2011 vet paditësja R. T. ka bërë Kallëzim penal për shpërdorim detyre ndaj Përmbaruesit Gjyqësor Pjetër Caka dhe prap organi i Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur mosfilliminn e procedimit penal Nr.315/2011 dt.26.09.2011.Kundra këtij vendimi paditësja R. T. është ankuar në Gjykatë dhe me vendimin Nr.19 datë 21.03.2012 është vendosur rrëzimin e kërkesë R. T. me objekt kundërshtim të vendimit mosfillimit procedimit penal nr.315/2011 si të pa bazuar në prova dhe në ligj. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin Nr.76 datë 04.06.2014 të Gjykatës Apelit Durrës. Në rastin konkret mendojmë se masat e marra nga ana juaj nuk kanë qënë të sakta dhe efektive për respektimin e kërkesave ligjore të parashikuara nga neni 606 i KPrC.

Duke patur parasysh se nga ana juaj nuk janë marrë të gjitha masat ligjore për ta detyruar palën e paditur për zbatimin e plotë të vendimeve gjyqësore, paditësja R, T, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese e cila me vendimin e saj Nr.4 datë 20.02.2013 ka vendosur konstatimin e cënimit e të drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë me Nr.540 datë 03.12.2007 të Gjykatës Apelit Durrës.

Edhe pas kësaj vendimi gjyqësor i formës së prerë nuk është ekzekutuar plotësisht nga ana juaj.

Rezulton se paditësja R, T, nga ana e saj i është drejtuar edhe Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, e cila me vendimin e saj me Nr.38964/13Çështja “T, kundër Shqipërisë”, ka vendosur pranimin e kërkesës së saj,

Në zbatim të këtij vendimi dhe të vendimit të GJEDNJ, Këshilli i Ministrave, me vendimin Nr.650 datë 22.07.2015 “Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, dt.24.03.2015”Për Çështjen “L, kundër Shqipërisë”, dhe 7 aplikime të tjera aplikimet me Nr.45718, Nr.9403/13, Nr.11724/13, Nr.11726/13, **Nr.38964/13**, Nr.6037/14, Nr.17174/14, Nr.48723/14”.

Në pikën 6 të këtij vendimi thuhet se ngarkohet Kryeministria, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Kapiteneria e Përgjithshme e Porteve Durrës, që brenda afatit 3 muaj nga dita kur vendimi i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut datë 24.03.2015, është bërë përfundimtar të ekzekutojnë në favor të aplikantëve vendimet përfundimtare të gjyktave vendase, për rikthimin e aplikantëve në pozicionet e mëparshme të punës.

Edhe në pikën 8 të këtij vendimi thuhet se ngarkohen Kryeministria, Departamenti i Administratës Publike, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Kapiteneria e Përgjithshme Porteve Durrës, për zbatimin e këtij vendimi.

Në lidhje me pretendimin tuaj se DAP i ka propozuar paditëses R. T. emërimin e saj në një detyrë tjetër ekuivalente si specialiste finance në Drejtorinë e Bujqësisë Durrës, nga verifikimet tona rezulton se paditësja ka deklaruar se nuk është dakord me këtë propozim dhe e ka refuzuar atë me arsyetimin e drejtë dhe të bazuar në ligj se ajo nuk e ka fituar akoma statusin e nënpunëses civile sipas legjislacionit në fuqi.

Në këto kushte, mendojmë se nga ana juaj duhet këmbëngulur më shumë për zbatimin e kërkesave të dispozitës ligjore të nenit 606 të KPrC deri në ekzekutimin e plotë të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, duke u bazuar kjo edhe në parashikimet ligjore të nenit 142/3 të Kushtetutës së RSH dhe të vendimit Nr.650 datë 22.07.2015 të Këshillit të Ministrave.

Në nenin 60/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, thuhet se: "Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike", dhe në nenin 63/3 të kësaj Kushtetute përcaktohet gjithashtu se: "Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave të Njeriut, nga administrata publike", pra institucioni ynë mban qëndrim të drejtë dhe institucional se në rastin konkret ka shkelje të të drejtave të njeriut, dhe nga ana juaj duhet të merren masat e nevojshme ligjore për ekzekutimin e plotë të vendimeve gjyqësore.

Për të gjitha këto arsye, ju

REKOMANDOJMË :

1.Marrjen e masave ligjore për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë me Nr.2918 datë 12.12.2006 të Gjykatës Rrethit Gjyqësor Durrës, për rikthimin në punën e mëparëshme të paditëses R. T.

2.Mbi masat e marra nga ana juaj në lidhje me pranimin e këtij rekomandimi, lutemi të na njoftoni me shkrim brenda 30 ditësh.

Duke besuar në mirrëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Areben SHKËMBI